



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



THIRRJE PUBLIKE

Për Mbështetje Financiare Publike të Organizatave Jo-Qeveritare në Zbatimin e Aktiviteteve të Kulturës dhe Sportit

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) e Komunës së Gjakovës, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës dhe të Sportit, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zbatimin e programit të DKRS-së së Komunës së Gjakovës.
2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare si në vijim:
 - a) Të gjitha OJQ-të në Komunën e Gjakovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës.
 - b) Të gjitha OJQ-të, Klubet Aktive Sportive në Komunën e Gjakovës programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Sportit.
3. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte të cilat kontribuojnë në zbatimin e aktiviteteve të Kulturës dhe të Sportit si me poshtë:
 - a) Aktivitetet që kanë për qëllim nxitjen e autoriteteve lokale, institucioneve publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile me qëllim ruajtjen, ngritjen, nxitjen dhe përcjelljen e frymës së Kulturës dhe Sportit tek shoqëria civile e më gjerë;
 - b) Bashkëpunimi i institucioneve publike dhe akterëve tjerë me shoqërinë civile për nxitjen dhe promovimin e aktiviteteve në fushën e Kulturës dhe Sportit.
 - c) Organizimi i aktiviteteve për shënimin e ngjarjeve të ndryshme në fushën e kulturës dhe sportit;
 - d) Mbështetja e aktiviteteve të përgjithshme Kulturore dhe Sportive.
 - e) Avancimi dhe promovimi i vlerave të mirëfillta në fushën e Kulturës dhe Sportit.
4. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për projektet individuale është 250.00 Euro.
5. Afati për dorëzimin e propozimeve është jo më pak se 15 ditë pune, duke filluar nga data **21.04.2022** dhe përfundon me datën: **17.05.2022**
6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti me dy (2) projekte në kuadër të kësaj thirrje, por vetëm një (1) projekt për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një (1) vit para datës së publikimit të thirrjes publike.

OJQ-të duhet po ashtu të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofertuesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofertuesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

7. Së bashku me aplikacionin, OJQ-të janë të obliguara të paraqesin dëshminë e Vërtetimit Tatimor të ATK-së dhe Vërtetimin e Gjykatës Ekonomike të OJQ-së. Nëse këto dokumente nuk paraqiten me rastin e aplikimit, atëherë aplikacioni konsiderohet i pavlefshëm.

8. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komuna e Gjakovë / Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (kk.rks-gov.net/gjakove/).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën: Adresa: Rr. "UÇK" p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës / Zyra e DKRS-së në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi".

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në zyrat e DKRS-së.

